

ABSTRAKT

Nisur nga fakti që posedimi ka një rëndësi të madhe për të drejtën, por gjithashtu edhe nga vështërësia që ai bartë në vetëvete, punimi dhe përmbajtja e kësaj teme, është e konceptuar në funksion të hetimeve shkencore për të sqaruar çfarë në fakt është posedimi, dallimi në mes poseduesit dhe pronarit, si fitohet posedimi, llojet e posedimit, objekti i posedimit, duke pasur për fokus edhe mënyrat e mbrojtjes në rastet e pengim posedimit si ofrim i zgjidhjeve meritore për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me posedimin nga ana e Gjykatave në nivel të vendit.

E drejta e pronarit që të posedojë në radhë të parë përbën posedimin, edhe pse e drejta gjithashtu pranon se posedimin ekziston edhe në një mënyrë apo tjetrën i pavarur nga pronësia. Posedimi nënkupton një pushtet faktik të një personi ndaj një sendi apo një e drejtë, për dallim nga pronësia e cila nënkupton pushtetin juridik të një personi mbi një send, si dhe pronësia nuk mund të dorëzohet sepse ajo nuk përfaqëson send trupor, por ajo përmban autorizime pronësore të një personi i cili ka të drejtë që sendin e vet ta disponojë, ta posedoj , përdorë-shfrytëzojë brenda kufijëve të caktuar me ligj. Ndërkaq, posedimi është pushtet faktik i një personi mbi një send trupor, që manifestohet pastaj me një aktivitet që i korrensponon ushtrimit të së drejtës së pronësisë

Legjislacionet në fuqi për posedimin përdorin nocione të ndryshme si; posedim i ligjshëm ose i paligjshëm, posedim me mirëbesim ose posedim me keqbesim, në varësi të plotësisë të kriterëve ligjore të caktuara. Këto koncepte juridike të posedimit natyrisht që gjejnë trajtimin e tyre në këtë punim. Posedimi përbën për të drejtën, një marrëdhënie juridike-civile e cila përfshin personat dhe sendet dhe një lidhje ndërmjet personit që posedonte i fundi posedimin dhe atij që i jep poseduesit të drejtën e posedimit. Nisur nga rëndësia që posedimi paraqet për të drejtën, ajo i garanton atij edhe një mbrojtje juridike të posaqme, të cilës gjithashtu i është kushtuar një vëmendje e duhur në këtë punim.

Fjalët kyçe; Posedim, pengim posedim, parashkrim fitues, praktikë gjyqësore, padi posedimore, mbrojtje gjyqësore.